



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1079 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Shaban Ademi kandidat për anëtar të Asamble Komunale nga rradhët e Subjektivit Politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) Komuna Vushtri, paraqitur kundër Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Shaban Ademi kandidat për anëtarë të Asamblesë Komunale në Vushtrri nga radhët e Subjektivit Politik LDK.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, ku pretenduesi ka theksuar se, sipas formularëve të përputhjes se të dhënave dhe rezultateve në Shaban Ademi si kandidat i LDK –së në Komunën e Vushtrisë kam marrë 204 vota, ndërsa pas shpalljes së rezultateve nga KQZ për kandidatët, mua si kandidat me jenë zbritur votat dhe tani sipas këtyre rezultateve të shpallura në figuroj që i kam 188 vota, pa kurrfar të drejte disa kandidatëve ua ka rritur numërimin e votave ndërsa mua mi ka zbritur, gjithashtu ka cekur se para një jave Kryetari i partisë në Vushtrri z. Hysni Gerguri para shpalljes së Rezultateve përafërsisht para një jave dite me ka thënë personalisht se nuk i ke 204 vot por i ke veq 108, ndërsa Bashkim Jashari, Gazmend Maxhuni, Kushtrim Neziri etj. Këta persona sipas formularëve të Përputhjes se të dhënave dhe rezultateve kanë qenë pas meje sepse kanë pasur numër më të vogël të Votimeve thjesht nuk ka pasur vota sa kam pasur në tani, kane vota me shumë se unë. Shkelje e dytë që konsideroi që KZAP duhet ta shqyrtoi është se në vendvotimin nr. 2701b / 06 R nga komisioneri i këtij vendvotimi me është thënë se në këtë vendvotim i ke pasur 6 vota ndërsa në rezultatin e FPR-ve asnjë votë nuk figuron. Gjithashtu shkelja e tjetër ka ndodhur në vendvotimin 2702x / 01 R.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të Shaban Ademit kandidat i LDK K. Vushtrisë ku pretendohet se ka manipulim me vota të rezultatit përfundimtar në të zgjedhjeve Lokale, për këtë çështje në fjalë parashtruesi i ankesës nuk qendërojnë sepse nuk ka ofruar prova të mjaftueshme më të cilën do të vërtetohej se është kryer një veprim i tillë, gjegjësisht zbritja e votave, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 1079 /2013 më datën 06.12.2013



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.